



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.387/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj, dhe Arsim Hamzaj, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.387/2025 të datës 05.02.2025, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me datë 05.02.2025 PZAP ka pranuar ankesën Anr.387/2025 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë 04.02.2025, kandidati për deputet nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Zafir Berisha, ka postuar në profilin e tij në facebook një tekst, ku duke përdorur gjuhë denigruese, akuzuese dhe urrejtëse me qëllimin dëmtues elektorale dhe nxitjes së urrejtjes ndaj Kryeministrit z. Albin Kurti dhe duke bërë akuza të pabazuara ka shkruar: *"Klithmat dhe piskamat cep në cep të Kosovës nga Albini, nuk kanë të bëjnë me nuhatjen e fii për humbje të pushtetit, Hallin e ka, se po e pretë Dubrava, milionat e vjedhura në KEK, rezervat shtetërore, tenderat një burimorë' etj etj, do të trajtohen nga organet e drejtësis, do a po nuk do ai". "Sulmet kundër prokurorisë të shtetit gjatë gjithëfushatës, dhe premtimi për themelimin e organeve paralele në drejtësi në kundërshtim me kushtetutën dhe ligjet nëfuqij është përpjekja e fundit që Albini po mundohet për me i ik Dubravës".* Si provë ka bashkangjitur, Fotografi dhe linku tekstit të shpërndarë në Facebook: <https://www.facebook.com/share/p/18nfPEmnVy/>

Në përgjigje në ankesë të paraqitur, subjekti politik PDK ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe kanë theksuar se përmes kësaj përgjigje, kërkon nga PZAP që ankesën e ankuesit t'a refuzoj si të pabazuar për arsye se kandidati për deputet z. Zafir Berisha nuk është pjesë e listës së PDK, andaj si i tillë, PDK nuk mund të mbahet përgjegjës për veprimet e kandidatëve të subjekteve tjera politike.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, dhe përgjigjes në ankesë të parashtruar nga subjekti politik PDK, vlerësoj se subjekti politik PDK nuka legjitimitet pasiv, andaj pretendimet e parashtruara në ankesë janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj si të pa bazuara, kjo për faktin se parashtruesi i ankesës i referohet shkëlqes së bërë nga ana e kandidatit të subjektit politik PDK Zafir Berisha, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë si dhe nga verifikimet e bëra të listës së kandidatëve të subjektit politik PDK që garojnë për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025 gjeti se kandidati Zafir Berisha nuk i përket dhe nuk është pjesë e listës së PDK,

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla të palës ankuese janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi të pabazuara.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Anr.387/2025 më datë 07.02.2025

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.